



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 38 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 13 dhe 14 të Ligjit për Procedurën Administrative nr.02/L28 dt. 22.07.2005, nenit 17 paragrafi 1 pika “b”, “d” dhe “e” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 dt. 20.02.2008, dhe nenit 57 shkronja “c” të Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-391 dt. 25.02.2010, duke vendosur sipas kërkesës me nr.05-392-191084 dt. 07.10.2013, Exclusive Design Company EXDC-2 me përfaqësues Kujtim Svirca, Drejtorja e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit i Komunës së Prishtinës, merr këtë:

V E N D I M

I. I LEJOHET investitorit Exclusive Design Company EXDC-2 me përfaqësues Kujtim Svirca, përdorimi i objekteve banimore-afariste të bllokut „C6” sipas Planit Rregullues në lagjen „Kalabri” lamela 8,10 dhe 12 me etazhitet 2B+P+6, në ngastrat kadastrale P-71914059-01832/5 dhe P-71914059-01832/6, Zona Kadastrale Prishtinë, të ndërtuar sipas Lejes së Ndërtimit me nr.05-351-3139 dt. 08.02.2012, të lëshuar nga Drejtorja e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

II. Objekti do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje nga pika I dhe dokumentacionin teknik .

III. Objekti nga pika I. e këtij Aktvendimi mund të përdoret dhe shfrytëzohet nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktvendimi.

IV. Ky Aktvendim do të shërbejë si bazë për regjistrimin e objektit të përshkruar në pikën I të këtij Aktvendimi në evidencat përkatëse Kadastrale.

A r s y e t i m

Exclusive Design Company EXDC-2 me përfaqësues Kujtim Svirca, me kërkesën 05 nr. 392-191084 dt. 07.10.2013, i është drejtuar Drejtorisë për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës Prishtinë, me të cilën ka kërkuar lëshimin e lejes së përdorimit të objekteve banimore-afariste të bllokut „C6” sipas Planit Rregullues në lagjen „Kalabri” lamela 8,10 dhe 12 me etazhitet 2B+P+6, në ngastrat kadastrale P-71914059-01832/5 dhe P-71914059-01832/6, Zona Kadastrale Prishtinë, të ndërtuar sipas Lejes së Ndërtimit me nr.05-351-3139 dt. 08.02.2012, të lëshuar nga Drejtorja e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës. me që rast ka dorëzuar këtë dokumentacion:

- o Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të objekteve investuese të dt. 05.10.2013.
- o Dokumentacionin përcjellës, ateste certifikatat etj

Drejtoria e Urbanizmit Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, pas shqyrtimit të provave të lëndës e konkretisht, procesverbalin e komisionit për kontrollim teknik të dt. 05.10.2013, ku secili anëtar ka bërë kontrollimin teknik të objektit ndërtimor investues dhe kanë konstatuar se, objektet investuese janë ndërtuar në pajtim me aktvendimin e cekur më lartë dhe dokumentacionin tjetër teknik dhe se i njëjti përmbushë normativat dhe standardet, aplikimi i të cilave është i domosdoshëm me rastin e ndërtimit të objekteve të tilla, për çka edhe ka propozuar që Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, t'i lëshoj lejen e përdorimi, andaj kjo Drejtori vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzimi juridik: Kundër këtij Vendimi mund të paraqitet ankesë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përmes kësaj Drejtorie në afat brenda prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktvendimi.

I dorëzohet: Investitorit, kadastër, në lëndë dhe arkivit.

**DREJTORIA E URBANIZMIT, NDËRTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
TË KOMUNËS SË PRISHTINËS 05 nr 392-191084 dt. 16.10.2013**

E punoi:
F.Rahmani jur.dipl.



E kontrolloi:
Ferit Fazliu, idn.dipl

